

18.09.2017

PKR.96/17



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKAPA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PER KRIME TE

RENDA - si gjykatë e shkallës së parë, me kryetaren e trupit gjykues Hysnije Gashi dhe zyrtarën ligjore Albana Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale grabitje në tentative nga neni 329 par.1 lidhur me 28 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti per Krime te Renda PP/I nr. 91/17 të datës 06.07.2017 pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar në prani te Prokurorit te shtetit, Burim Qerkini të akuzuarit [REDAKTUAR], mbrojtësit te tij av. [REDAKTUAR], me dt. 19.07.2017 shpall dhe publikisht komunikon, ndërsa me datë 31.07.2017 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj te akuzuarit:

[REDAKTUAR] i lindur me date [REDAKTUAR] ne Fshatin [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR] i ati [REDAKTUAR], e ëma [REDAKTUAR], e vajzërisë [REDAKTUAR], me vendbanim të njëjtte, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka te kryer shkollën e lartë të PTT-së, me nr. personal [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes se mire ekonomike. Në paraburgim ka qëndruar nga dt.09.06.2017.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 09 qershor 2017, rrethe orës 12:45, në Qendrën tregtare "[REDAKTUAR]" në Ferizaj, me kanosje serioze për të sulmuar jetën e të dëmtuarit [REDAKTUAR], ka tentuar që të përvetësoj pasurinë e luajtshme, me qëllim që vetës ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme, në atë mënyre që ka hyrë brenda në qendrën tregtare, me ç' rast iu ka kanosur të dëmtuarit që t' ja dorëzoj paratë e arkës ose të përdorë armën në atë mënyre që ka simuluar se kinse posedon armë, duke e mbajtur në gjepin e jaknës ku kishte një mjet

për mbathje të këpucëve, mirëpo kanë intervenuar sigurimi i objektit dhe e kanë arrestuar të pandehurin derisa kanë ardhur policia.

- Me këtë ka kryer veprën penale grabitje në tentative nga neni 329 par.1 lidhur me 28 të KPK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, i

G J Y K O N

Të akuzuarin:

I. **[REDAKTUAR]**, DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 1 (një) VITI

Në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 09 qershor 2017 deri me 19.07.2017.

II. DHE DËNIM ME GJOBE ne shumen prej 200 Euro, të cilin dënim është i detyruar ta paguajë menjëherë pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me neni 46 paragrafi 3 të KPRK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20€ do të vuaj nga një ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50€ /pesëdhjetë euro/, dhe shpenzimet e procedurës penale ne shumen prej 20€ /njëzetë euro/ në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda ka ngrit aktakuzën PP/nr.91/17 të datës 06.07.2017 kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale grabitje në tentative nga neni 329 par.1 lidhur me 28 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar publik me date 19.07.2017 në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Burim Qerkini lexoi aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda PP/nr.91/17 të datës 06.07.2017.

I pandehuri [REDAKTUAR] ne shqyrtimin fillestar me rastin e njoftimit për te drejtën e tij qe te pranoje fajësinë apo te deklarohet i pafajshëm ne kuptim te nenit 325 te KPPK-se, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale grabitje në tentative nga neni 329 par.1 lidhur me 28 të KPK-së.

Prokurori i Shtetit Burim Qerkini, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 383 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
-pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit ne shqyrtimin fillestar dhe atë: vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve

i datës 09.06.2017, shikimi në CD-në, me video inqizime dhe kamerat e sigurisë në Qendrën Tregtare "██████" si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale grabitje në tentative nga neni 329 par.1 lidhur me 28 të KPK-së për të pandehurin ████████ të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, edhe atë: veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ruajtjen e paprekshmërisë së pronës dhe të drejtave pasurore të personave fizik dhe juridik, kjo vepër është kryer me ane të veprimeve aktive dhe të kundërligjshme në atë mënyrë që me përdorimin e forcës duke hyrë në mënyrë të paligjshme në Qendrën tregtare "██████" në ████████, me kanosje serioze për të sulmuar jetën e të dëmtuarit ████████, ka tentuar që të përvetësojë pasurinën e luajtshme, me qëllim që vetës ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme, në atë mënyrë që ka hyrë brenda në qendrën tregtare, me ç' rast iu ka kanosur të dëmtuarit që t'ja dorëzojë paratë e arkës ose të përdorë armën në atë mënyrë që ka simuluar se kinse posedon armë, duke e mbajtur në gjepin e jaknës me qëllim të posaçëm për të nxjerrë përfitime materiale, pasi që i pandehuri jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij por edhe ka dëshiruar edhe ardhjen e tyre, çka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73,74 dhe 75 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethanë veçanërisht lehtësuese i

mori parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50€ /pesëdhjetë euro/, dhe shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€ /njëzetë euro/ në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti për Krime të Renda,

PKR.nr.95/17, Me datë 31.07.2017

Zyrtare ligjore,

Albana Ujupi



Kryetarja e trupit gjykues,

Hysnije Gashi

Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 /pesëmbëdhjete/ ditëve nga dita e pranimin të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate